

Njoftim për Përqendrim që i referohet blerjes së kontrollit të plotë nga VEGA SHPK Valevo, Republika e Serbisë mbi PZU Barnatorja BENU Podgoricë, Mali i Zi, Farmegra d.o.o. Podgoricë, Mali i Zi, Feniks d.o.o. Bijelina, Republika Srpska, Bosnja dhe Hercegovina dhe Feniks Farma SHPKNJP Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,

(lënda nr. 08-55 /2025)

Sipas nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.03.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës iu dorëzua një njoftim për përqendrim me të cilën VEGA SHPK Valevo me seli në Dr Bore Blagojeviça, nr. 30 Valjevo, Serbi do të fitojë kontroll të plotë mbi PZU Barnatorja BENU Podgoricë me seli në Kritskog odreda 4/1, Podgoricë, Mali i Zi, Farmegra d.o.o. Podgoricë me seli në Kritskog odreda 4/1, Podgoricë, Mali i Zi, Feniks d.o.o. Bijelina me seli në Donja Lelença 015B, Lelença Bijelina, Republika Srpska, Bosnja dhe Hercegovina dhe Feniks Farma SHPKNJP Shkup me seli në Jadranska Magistrala, nr. 31 Shkup - Butel, Maqedoni e Veriut, duke blerë drejtpërdrejtë 100% të pjesëve në shoqëritë.

-**VEGA SHPK VALJEVO** me seli në Dr Bore Blagojeviça, nr. 30 Valevo, Serbi është një shitës me shumicë që merret me import, blerje, ruajtje, shitje dhe shpërndarje të ilaçeve, pajisjeve mjekësore, produkteve dietetike, kozmetikës dhe produkteve për qëllime të përgjithshme.

-**PZU Barnatorja BENU Podgoricë** me seli në Kritskog odreda 4/1, Podgorica, Mali i Zi është një institucion privat shëndetësor që kryen tregti të vogël me produkte farmaceutike në dyqane të specializuara – barnatore, dyqane të vogla që shesin ilaçe me recetë. Asortimenti i tyre përfshin edhe ilaçe pa recetë, pajisje mjekësore, suplemente ushqimore, kozmetikë dhe artikuj për qëllime të përgjithshme.

-**Farmegra d.o.o. Podgoricë** me seli në Kritskog odreda 4/1, Podgoricë, Mali i Zi kryen shitje të ilaçeve dhe produkteve para-farmaceutike nga prodhuesit vendorë dhe ndërkombëtarë.

-**Feniks d.o.o. Bijelina** me seli në Donja Lelença 015B, Lelença Bijelina, Republika Srpska, Bosnja dhe Hercegovina është një shitës me shumicë që furnizon barnatore, spitale dhe institucione shëndetësore të tjera me ilaçe dhe produkte farmaceutike të tjera.

-**Feniks Farma SHPKNJP Shkup** me seli në Jadranska Magistrala, nr. 31 Shkup - Butel, Maqedoni e Veriut është një shitës me shumicë që kryen tregti të madhe me produkte farmaceutike, duke përfshirë importin, ruajtjen, shitjen dhe shpërndarjen e ilaçeve, pajisjeve mjekësore dhe suplementeve ushqimore nga prodhuesit vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në bazë të hetimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se Përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e interesuara të treta të paraqesin komentet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të interesuara të treta mund të dërgohen në adresën: rruga „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup ose nëpërmjet e-mail:

kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të mbërrijnë te Komisioni brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

06.03.2025

Shkup